



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr 875 Prot.

Gjirokastrë më, 13.05.2026

V E N D I M

Nr. 02 , datë 13.05.2026

P Ë R

NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 01, DATË 12.05.2026 TË
KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Bazuar në Urdhrin e Rektorit nr. 70, datë 11.05.2026, nr. 826 Prot., në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", veçanërisht nenin 6 pika 2, shkronja "a" dhe "b", si dhe në kuadër të saktësisimit të procedurës së aplikimit për procesin zgjedhor, Komisioni Institucional Zgjedhor.

V E N D O S I:

1. Të ndryshojë pikën 2 të Vendimit nr. 01, datë 12.05.2026 të Komisionit Institucional Zgjedhor, e cila ishte me përmbajtje:

"2. Të njoftohet KZF e FE-së për të filluar procesin e aplikimit për autoritetin "Drejtues i Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit" në Fakultetin Ekonomik. Aplikimi fillon më datë 13.05.2026, ora 08:00 deri më 17.05.2026, ora 16:00."

2. Pika 2 e Vendimit nr. 01, datë 12.05.2026 ndryshohet si më poshtë:

"2. Ngarkohet Komisioni Zgjedhor i Fakultetit Ekonomik (KZF-FE), në përputhje me rregulloren për organizimin e zgjedhjeve, për fillimin e procesit zgjedhor për autoritetin 'Drejtues i Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit' në Fakultetin Ekonomik."

3. Të gjitha pikat e tjera të Vendimit nr. 01, datë 12.05.2026 mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim KZF-së së Fakultetit Ekonomik, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit dhe në mjediset e Fakultetit Ekonomik.

KRYETARI

Famira Boboli

ANËTAR

Bitla Zulli

ANËTAR

Dhori Tempa



ANËTAR

Blerida Korre

ANËTAR